



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

---

**PLANI I VEPRIMIT I FAKULTETIT TE  
SHKENCAVE KOMPJUTERIKE PËR VITIN  
AKADEMIK 2024/2025**

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| 1. Hyrje .....  | 3  |
| 2. Historik i shkurtër i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike.....  | 4  |
| 3. Misioni I Fakultetit të Shkencave Kompjuterike .....             | 6  |
| 4. Vizioni I Fakultetit të Shkencave Kompjuterike .....             | 7  |
| 5. Vlerat .....   | 7  |
| 6. Objektivat strategjike të fakultetit Shkenca Kompjuterike .....  | 8  |
| 7. Organizimi dhe zhvillimi i fakultetit Shkenca Kompjuterike ..... | 12 |
| 8. Mësimdhënia.....   | 13 |
| 9. Hulumtimi .....  | 15 |
| 10. Studentët.....  | 17 |
| 11. Personeli Akademik dhe administrativ .....                      | 19 |
| 12. Cilësia .....   | 20 |
| 13. Infrastruktura dhe pajisjet .....                               | 28 |
| 14. Plani i detajuar i veprimit .....                               | 33 |

# 1. Hyrje

Plani i Veprimit i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike është përgatitur nga personeli akademik i këtij fakulteti me qëllim që të shërbejë si një udhërrëfyes i vlefshëm për institucionin akademik, stafin akademik dhe studentët, në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit.

Ky plan do të jetë në përputhje të plotë me kornizën normative të Universitetit Publik “Kadri Zeka” (UKZ), duke mbështetur qëllimet strategjike të universitetit dhe nevojat e tregut të punës. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike synon të ofrojë programe akademike që përputhen me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe të përshtaten me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe digjitale, për të përgatitur studentët që të ndërtojnë një të ardhme të sigurt për veten dhe kontribut për vendin e tyre.

Në këtë plan do të përfshihen të dhëna mbi zhvillimin e fakultetit, vizionin, misionin dhe qëllimet kryesore të tij. Gjithashtu, do të përmenden synimet për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit brenda programeve studimore, përmirësimin e infrastrukturës dhe mbështetjen për hulumtime shkencore.

Në kuadër të këtij plani, do të paraqiten programet ekzistuese dhe ato të reja që planifikohen të zhvillohen për të përgatitur studentët me aftësi që përmbushin kërkesat e sektorëve të ndryshëm teknologjikë. Do të theksohet roli i teknologjive të reja, përfshirë zhvillimet në inteligjencën artificiale, inxhinierinë e softuerit dhe sigurinë kibernetike, të cilat do të jenë thelbësore për profilizimin e studentëve në tregun global të punës.

Në fund të Planit të Veprimit, do të paraqitet një përmbledhje e pikave kyçe të këtij plani, duke nënvizuar përpjekjet për përmirësim të vazhdueshëm dhe adaptim ndaj nevojave të reja. Për ta bërë të plotë këtë dokument, do të përfshihet edhe një tabelë me të dhëna themelore që ofron një pasqyrë të qartë mbi planin e veprimit dhe objektivat afatgjata të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

## 2. Historik i shkurtër i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike u themelua më 1 tetor 2014 dhe filloi me 50 studentë aktivë në vitin akademik 2014/2015. Me kalimin e viteve, numri i studentëve është rritur në mënyrë të qëndrueshme, dhe deri në vitin 2024 janë regjistruar gjithsej 1642 studentë në nivelet bachelor dhe master.

Fokusi ynë i veçantë është Teknologjia, përkatësisht specializimi në Inxhinieri Softuerike dhe Dizajn Ueb, si dhe Teknologjia e Sistemit dhe Kontrollit. Këto fusha na vendosin në qendër të edukimit dhe inovacionit, duke përgatitur gjenerata të reja për një të ardhme ekonomike progresive. Qëllimi ynë është të përgatisim studentë që:

- të kontribuojnë në tregun e punës në role të ndryshme profesionale,
- të jenë të aftë për të hapur bizneset e tyre në fushën e zhvillimit të sistemeve dhe aplikacioneve të ndryshme.

Si pjesë e misionit të tij, Fakulteti përgatit gjenerata që kontribuojnë në fushën e teknologjisë për Kosovë, Evropë dhe Amerikë, duke u fokusuar në mundësitë e punës në distancë (remote) nga Kosova për kompani ndërkombëtare. Përmes edukimit të ofruar në FSHK, synohet gjithashtu përmirësimi i ndërgjegjes individuale dhe sociale.

Programe studimore në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike

Aktualisht, Fakulteti ofron programet e mëposhtme të akredituara për periudha të ndryshme:

- Shkencat Kompjuterike, BSc, 180 ECTS – riakredituar për periudhën 5-vjeçare (1 tetor 2021 - 30 shtator 2026)
- Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MSc, 120 ECTS- riakredituar për periudhën 3-vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027)
- E-Qeverisja, MSc, 120 ECTS – riakredituar për periudhën 3-vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027)

Mundësitë e karrierës për të diplomuarit në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike

Duke u bazuar në programet e studimit që përqendrohen në teknologji, inxhinieri të softuerëve, dizajn të uebsajteve dhe inteligjencë artificiale, të diplomuarit kanë një gamë të gjerë mundësish karriere. Disa prej tyre përfshijnë:

- Inxhinier i Softuerit: Punon në zhvillimin e aplikacioneve, sistemeve të softuerit dhe zgjidhjeve.
- Zhvillues/Dizajner i Uebsajteve: Merret me krijimin dhe mirëmbajtjen e uebsajteve dhe ndërfaqeve të përdoruesit.
- Inxhinier i Sistemit dhe Kontrollit: Projekton dhe mirëmban sisteme kontrolli për automatizim, robotikë dhe industri.
- Inxhinier i Inteligjencës Artificiale: Zhvillon algoritme dhe aplikacione që përdorin inteligjencën artificiale.
- Specialist i E-Qeverisjes: Zhvillon sisteme elektronike për proceset qeveritare, duke përmirësuar efikasitetin dhe transparencën.
- Konsultant Teknologjik: Ofron këshilla teknologjike për biznese në industri të ndryshme.
- Sipërmarrës në Teknologji: Themelon biznese të reja në fushën e zhvillimit të softuerit dhe shërbimeve IT.
- Punësim në distancë: Fokusi i fakultetit përgatit studentët për karriera remote, duke kontribuar në projekte ndërkombëtare.
- Kërkim dhe Zhvillim: Të diplomuarit e nivelit master mund të angazhohen në kërkime për zgjidhje inovative në shkencat kompjuterike.
- Edukator/Trajner: Ndarja e njohurive dhe mësimdhënia në institucione akademike ose përmes programeve trajnimi.

Ky Fakultet mbetet një pikë referimi për edukimin në teknologji dhe synon të vazhdojë të formojë profesionistë të përgatitur për sfidat e botës digjitale.

### 3. Misioni I Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Në përputhje me misionin e universitetit, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike synon të kultivojë një ambient të dijes dhe inovacionit, duke i përgatitur studentët për një treg pune global dhe virtual, me theks të veçantë në teknologjitë e informacionit. Fakulteti angazhohet të zhvillojë mendimin kritik dhe aftësitë ndërmarrëse të studentëve, duke kontribuar kështu në përparimin shkencor, teknologjik dhe social.

Misioni ynë përqendrohet në disa shtylla kryesore:

**Përgatitja e studentëve me njohuri dhe aftësi profesionale:** Fakulteti synon të edukojë gjenerata të reja me njohuri të avancuara në shkencat kompjuterike, kompetenca teknologjike dhe kapacitete të mjaftueshme për të konkurruar në tregjet globale të punës.

**Kontributi në kërkime dhe inovacion:** Duke nxitur hulumtimet shkencore dhe ndërmarrjen e nismave të reja teknologjike, fakulteti synon të përforcojë rolin e tij në përparimin e teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Angazhimi në komunitet dhe zhvillimi shoqëror:** Fakulteti përkushtohet në përmirësimin e ndërgjegjes individuale dhe sociale, duke formuar të rinj të përgjegjshëm që kontribuojnë në zhvillimin e një shoqërie moderne dhe konkurruese, të aftë të udhëheqin projekte teknologjike dhe të kontribuojnë për komunitetin lokal e më gjerë.

Duke ndjekur parimet e universitetit, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike synon të jetë një pikë referimi për edukimin në fushën e teknologjisë dhe një model për zhvillimin e aftësive në një shoqëri të hapur dhe të përparuar.

## 4. Vizioni I Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike synon të bëhet një ndër institucionet kryesore në rajon në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike, duke udhëhequr në cilësinë akademike, inovacion dhe kërkim shkencor. Fakulteti ka për qëllim të krijojë një ambient që avanco dijen dhe inovacionin teknologjik, duke u përgatitur të kontribuojë në zhvillimin dinamik shoqëror dhe ekonomik të Kosovës dhe më gjerë.

Në përputhje me vizionin e universitetit, Fakulteti ynë aspron të jetë një urë lidhëse midis vlerave lokale dhe atyre globale, duke edukuar liderët e së ardhmes në industrinë e teknologjisë dhe duke promovuar diversitetin kulturor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Me fokus në përparimin e teknologjisë dhe zhvillimin e një shoqërie dixhitale, fakulteti synon të përgatisë studentë të aftë për të përballuar sfidat e shekullit të teknologjisë informative dhe të globalizmit, të cilët janë të angazhuar për të kontribuar në mirëqenien dhe përparimin e shoqërisë.

## 5. Vlerat

Disa vlera kryesore që përfaqësojnë fakultetin:

1. Ekselencia Akademike - Përkushtimi ndaj cilësisë së lartë në arsim dhe kërkime shkencore.
2. Inovacioni - Promovimi i krijimtarisë dhe zgjidhjeve të reja në teknologjitë e informacionit.
3. Mendimi Kritik dhe Ndërmarrësia - Zhvillimi i aftësive për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse, duke inkurajuar shpirtin ndërmarrës.
4. Integriteti dhe Përgjegjësia - Nxitja e ndërgjegjes profesionale dhe sociale te studentët dhe stafi akademik.
5. Angazhimi për Komunitetin
6. Kontributi në zhvillimin social dhe ekonomik të Kosovës dhe më gjerë, përmes edukimit dhe teknologjisë.
7. Diversiteti dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

8. Respektimi dhe integrimi i vlerave kulturore lokale dhe globale, me theks në partneritete ndërkombëtare.
9. Përparimi Teknologjik
10. Synimi për të qenë në ballë të zhvillimeve teknologjike dhe dixhitalizimit.
11. Liderizmi dhe Përgatitja për të Ardhmen
12. Formimi i liderëve të së ardhmes në industrinë e teknologjisë, të aftë për të udhëhequr ndryshimet në një botë gjithnjë e më të globalizuar.

Këto vlera i japin Fakultetit të Shkencave Kompjuterike një identitet të fortë dhe e vendosin atë si një institucion që përqafton dhe përparon përmes teknologjisë, inovacionit dhe përgjegjësisë shoqërore.

## 6. Objektivat strategjike të fakultetit Shkenca Kompjuterike

- Sigurimi i cilësisë dhe plotësimi i standardeve akademike, për të fituar akreditimin për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor), dhe të ciklit të dytë (Master)
- Mbështetje për zhvillimin dhe fuqizimin e të gjitha specializimeve me profilet përkatëse të studimeve dhe hulumtimeve.
- Hapja e studimeve të Doktoratës për kualifikim të stafit të ri në FSHK, duke ju ofruar studenteve të doktoratës kushte për hulumtime dhe kërkime shkencore, në mënyrë që të përfundojnë brenda afatit punimin e doktoratës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Fuqizimi i laboratorëve në studimet bachelor dhe master me anë të aplikimit në projekte, konkretisht projekte të infrastrukturës laboratorike për specializimet përkatëse të studimeve.
- Pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori (workshope), duke mbështetur financiarisht nga fondet e MASHT, Këshilli Drejtues i UKZ-së dhe donatorët (miqtë e FSHK-së në UKZ) për pjesëmarrjen e stafit për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm shkencor.



- Mbështetje për përsosjen e mësimdhënies në programet e studimit Bachelor dhe Master, me qëllimin parësor për përgatitjen e të diplomuarve në Master shkencorë, të ofruar nga FSHK, në mënyrë të tillë që të diplomuarit mund të kryejnë punë kërkimore të kualifikuar; duke zhvilluar më tej progresin shkencor dhe teknologjik; si dhe për të krijuar një klasë udhëheqëse me nivel të lartë profesional.
- Puna studimore dhe projektuese në Master do të synojë që studentët e FSHK-së në mënyrë individuale të pasurojnë njohuritë kërkimore shkencore gjatë përgatitjes së tezës së diplomës master, duke thelluar gjithnjë e më shumë përgatitjen teoriko-shkencore dhe sidomos atë praktike në drejtimet më bashkëkohore të teknologjive në fushat përkatëse.
- Do të krijohen kushte për hapjen e programit të studimit në Master Profesional në bashkëpunim me universitete jashtë vendit. Për këtë ndihmesë të madhe do të japë bashkëpunimi i ngushtë me kolegët nga Kosova nga universitetet më në zë në Evropë dhe më gjerë, dhe me profesorë të tjerë të huaj të ftuar në FSHK.
- Bashkëpunimi me institucione të tjera, për të përfutur eksperiencë në laboratorë kërkimore me emër në fushën përkatëse. Kjo duke shfrytëzuar lidhjet mes akademikësh jashtë vendit.
- Do të kërkohet mbështetje financiare me projekte të përbashkëta me universitetet e BE-së, në kuadër të projekteve të financuara nga BE; të bashkëpunimit me organizatat relevante ndërkombëtare që mbështesin UKZ-në dhe FSHK-në, si dhe mundësi të tjera për të vizituar laboratorët më me eksperiencë jashtë vendit, në kuadër të fondit të MASHT nga projektet të kërkimit dhe zhvillimit.
- Mbështetje për përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturën në mjediset e FSHK-së, sidomos për studentët, por edhe për punëtorët akademikë dhe administrativë. Qëllimi parësor do të jetë përmirësimi i kushteve në këto mjedise për të zhvilluar ligjërata dhe ushtrime me mjete bashkëkohore teknologjike dhe me nivel të lartë profesional. Përpjekje për zgjerim hapësirash brenda FSHK-së, salla mësimi, laboratore dhe mjedise të tjera për studentët dhe stafin akademik, duke kërkuar mbështetje nga instancat përkatëse.

- Përpjekje për aftësimin praktik të studentëve në të dy ciklet e studimit jo vetëm në mjediset brenda FSHK-së, por edhe jashtë, në lidhje të ngushtë me kompanitë e zhvillimit të Softuerit, kompanitë/korporatat energjetike, kompanitë telekomunikimeve, ISP-të, kompanitë që ofrojnë shërbime elektronike, të automatizuara dhe robotike që ofrojnë mundësi bashkëpunimi për të gjitha fushat e FSHK-së.
- Bashkëpunim me sektorin e industries për zhvillimin e praktikës profesionale (internship) në mënyrë sa më cilësore dhe me përfitim të ndërsjellët për studentët.
- Bashkëpunim të ngushtë për zhvillim punime tezash dhe udhëheqjen e tyre, për mbështetje në procesin mësimor, për projekte kërkimore të përbashkëta, por edhe për mbështetje në përmirësimin e kushteve të mësimdhënies në FSHK.
- Përmirësim dhe kërkesë për rritjen e cilësisë së punës në administratën e FSHK-së.
- Avancim i digjitalizimit të shërbimeve mësimore dhe financave, të nisur tashmë gjatë periudhës së mëparshme, digjitalizimi i gjithë proceseve dhe veprimtarive përkatëse të tyre.
- Pasurim i Bibliotekës në UKZ me tituj librash, revistash, ose dhe me regjistrim on-line në internet, për të zgjeruar më tej informacionin për studentët dhe stafin, duke u përpjekur për të qenë gjithmonë në përditësim me arritjet e reja në fushat e studimeve që ofrohen në FSHK.
- Përpjekje për informim të shpejtë, të gjerë dhe të saktë për studentët, stafin dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë.
- Përmirësim i kushteve dhe rritje e kërkesës në FSHK për informimin e studentëve gjatë procesit mësimor, për sqarimin e tyre dhe të interesuarve të tjerë në kohë dhe cilësinë e duhur. Kjo në lidhje me orarin mësimor, ecurinë e regjistrimit, të zhvillimit të provimeve, të praktikave, mbrojtjes së diplomave etj, për arritjet në veprimtarinë botuese, mësimore, kërkimore që zhvillohen.
- Pozita e qëndrueshme si një qendër e shembullore e arsimimit të lartë dhe hulumtimeve shkencore softuerike dhe inxhinierike në Kosovë dhe regjion.

- Edukimi i të diplomuarve me kualifikime të larta të cilët mund të përballen me sfidat e ekonomisë globale për tregun lokal, regjional dhe internacional të punës.
- Kontributi në zhvillimin e shoqërisë duke siguruar trajnim të vazhdueshëm dhe programe të mësimin për avancimin e njohurive dhe përvojave.
- Tërheqja e studentëve me potencial të lartë nga shkollat e mesme.
- Hapja e mundësive të bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare të edukimit të lartë si dhe në hulumtimet inxhinierike.
- Avancimi dhe forcimi i rolit të Bordit Industrial Këshillëdhënës, i cili përbëhet nga përfaqësues nga sektori industrisë në Kosovë, dhe i cili shërben si urë lidhëse në mes të edukimit universitar, punës praktike të studentëve, sektorit të industrisë dhe kërkesave të tregut të punës.
- Zhvillimi i programit të ri të studimeve master i cili do të ofrohet në gjuhën angleze.
- Sigurohet pjesëmarrja në fondet Evropiane të dedikuara për edukim të lartë si: Erasmus +, Horizon 2020 etj.
- Zhvillimi i studimeve të përbashkëta të doktoratës me partnerë ndërkombëtar.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës në mënyrë që të plotësohen kërkesat dhe të zbatohen objektivat e hapësirës vendore, regjionale dhe evropiane të hulumtimit.
- Përforcimi i lidhjeve të hulumtimit shkencor dhe të zhvillimit me organizatat industriale të vendit dhe më gjerë.
- Ngritja e një fuqie konkurruese të punës e cila do të stimulon investimet në Kosovë.
- Përmirësim të njohurive të studentëve dhe zotërimi, rritja e të menduarit kritik, kalimi në metoda të reja të Mësimdhënies larg formatit të ligjëratave të thjeshta, evoluim në një sistem testimi formativ (p.sh. të bazuar në kompetencë, aktiv/të aplikuar etj.)
- Përmirësimi dhe përditësimi i programeve të studimit (në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe zonën Evropiane të arsimit të lartë)

- Mbështetja e të mësuarit të bazuar në hulumtim, përmirësimi i mjediseve fizike dhe virtuale për studentët e FSHK-së
- Rritja e numrit të mundësive për stafin dhe studentët e FSHK-së për të udhëtuar, krijuar rrjete globale dhe për të rritur produktivitetin e tyre.
- Përkrahja e inovacioneve dhe mbrojtja e pronës intelektuale të stafit mësimdhënës të FSHK-së.
- Ngritja e nivelit të botimeve të literaturës universitare për student.
- Krijimi i partneriteteve strategjike me institucionet me reputacion ndërkombëtar
- Shtimi i potencialit të alumni (të diplomuarve) për zhvillim të mëtutjeshëm të FSHK-së
- Të bëhen analiza të tregut për të identifikuar se cilat programe janë relevante me nevojat e tregut dhe të rritet numri i partnerëve nga tregu i punës
- Rritja e numrit të studentëve të përfshirë në të gjitha proceset për sigurim të cilësisë dhe konkurrencës në FSHK
- Shfrytëzimi i infrastrukturës së UKZ-së për të implementuar misionin e FSHK-së.
- Trajnimi i stafit akademik për të hartuar projekte ndërkombëtare.

## 7. Organizimi dhe zhvillimi i fakultetit Shkenca Kompjuterike

Objektivat zhvillimore të cilat njëherit janë edhe caqet e FSHK-së për zhvillimin e veprimtarisë kërkimoro- shkencore në periudhën vijuese:

- Objektivi 1: Zhvillim i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimoro- shkencore në FSHK.
- Objektivi 2: Funkcionalizimi dhe avancimi i infrastrukturës për punë kërkimore e shkencore për ofrimin e shërbimeve të komunitetit.
- Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore duke stimuluar përsosmërinë në kërkime.

- Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.
- Objektivi 5: Nxitja e hulumtimit të përbashkët mësimitdhënës-student.
- Objektivi 6: Hapja e programeve të reja master me profile inovative dhe të kërkuara si siguria kibernetike (cyber security), zhvillimi i lojërave (gaming), inteligjenca artificiale (AI) dhe fusha të tjera me potencial zhvillimi.
- Objektivi 7: Krijimi i programeve PhD nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, si dhe nxitja e bashkëpunimit me universitete të tjera për ofrimin e doktoraturave të përbashkëta.
- Objektivi 8: Zhvillimi i programeve akademike në gjuhën angleze për të rritur atraktivitetin për studentë ndërkombëtarë dhe për të përkrahur ndërkombëtarizimin e institucionit.

## 8. Mësimdhënia

Mësimdhënia dhe mësim-nxënia në programet studimore të UKZ bazohet, fillimisht në rregulloret e aprovuara nga ana e Senatit. Ky proces është i orientuar kah studenti: studenti është qendra dhe i gjithë procesi funksionon në interes të ngritjes së tij intelektuale, hulumtuese dhe sociale.

Disa prej përparësive të UKZ janë:

- syllabuset e lëndëve rishikohen dhe miratohen në KF në fillim të semestrit;
- ligjëratat dhe ushtrimet organizohen me qasje dhe metoda fleksibile për studentin;
- përveç librave obligativë dhe atyre të sugjeruar, studentëve u vihen në dispozicion edhe materiale të nevojshme konkretizimi;
- organizohen vlerësime periodike dhe të vazhdueshme-gjatë tërë semestrit;
- përdorimi i IT-së dhe aplikacionit e-learning ([SMU](#), [Moodle](#), [TEdu](#), [Google](#));
- konsultimet e rregullta me mësimitdhënësit etj.

- në të gjitha programet studimore kujdes i kushtohet punës praktike; në disa programe në Fakultetin e Edukimit, në Fakultetin e Shkencave Aplikative, në Fakultetin Juridik, praktika është pjesë obligative e programit studimor.
- Mësim-nxënia plotësohet edhe me aktivitete të lira akademike, të cilat zhvillohen përmes klubeve të ndryshme, si Klubi i Oratorëve, Klubi i IT, Klubi i Matematikanëve, të cilat mbajnë gara në fushat e tyre.

**Mësimdhënia** në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike është e orientuar drejt përgatitjes së studentëve me njohuri të avancuara dhe aftësi profesionale, duke u siguruar që ata të jenë të gatshëm për tregun global të punës. Procesi mësimor fokusohet në:

**1. Cilësi të lartë akademike:**

- Zbatimi i metodologjive të reja mësimore që mbështesin mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve komplekse.

**2. Praktikë dhe aplikim teknologjik:**

- Ndërthurja e teorisë me praktikat teknologjike më të fundit për të garantuar kompetenca teknologjike të studentëve.

**3. Mbështetja e zhvillimit ndërmarrës:**

- Stimulimi i kreativitetit dhe inovacionit të studentët, për të zhvilluar aftësitë e tyre ndërmarrëse.

**4. Qasja globale:**

- Përgatitja e studentëve për të konkurruar në një treg pune ndërkombëtar dhe për t'u përballur me sfidat e globalizmit.

Mësimdhënia në fakultet synon të krijojë një ambient frymëzues, ku studentët të ndihen të motivuar për të mësuar dhe për të kontribuar në avancimin e shkencave kompjuterike dhe zhvillimin teknologjik.

## 9. Hulumtimi

Plani Strategjik i UKZ për periudhën 2023-2028, i rishikuar në vitin 2023, përfshin një kapitull të veçantë mbi objektivat strategjike, ku **Objektivi Strategjik 2** fokusohet në zhvillimin e aktivitetit shkencor për përmirësimin e cilësisë së studimeve dhe nxitjen e inovacionit. Për këtë qëllim, është planifikuar rritja e mbështetjes financiare për hulumtimet shkencore.

### Mekanizmat për Avancimin e Hulumtimit

- **Themelimi i Instituteve Hulumtuese:** Planifikohet krijimi i të paktën dy instituteve kërkimore, secili me një projekt hulumtues aktiv.
- **Projekte Prioritare:** Planifikimi dhe zhvillimi i projekteve kërkimore me përparësi.
- **Avancimi i Stafit:** Zhvillimi i mekanizmave për përmirësimin e punës shkencore të stafit akademik.
- **Fonde për Hulumtim:** Rritja e pjesëmarrjes në fondet vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë ato të BE-së.
- **Promovimi i Punës Shkencore:** Krijimi i platformave dhe mekanizmave për promovimin e punës kërkimore të universitetit.

### Objektivat Kërkimore të Programit

1. Zhvillimi i stafit dhe studentëve për metodologjinë e kërkimit shkencor.
2. Përfshirja në projekte rajonale dhe ndërkombëtare.
3. Publikimi i punimeve shkencore (të paktën një për staf çdo vit).
4. Nxitja e bashkëpunimit profesor-student në kërkim.
5. Themelimi i laboratorëve për kërkime në fusha specifike, si shkencat sociale.
6. Aplikimi në fonde vendore dhe ndërkombëtare për projekte kërkimore.
7. Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore dhe aktivitete profesionale.

### Mbështetja Financiare dhe Infrastrukturale

- Financimi i së paku dy publikimeve shkencore në vit për secilin staf akademik në databazat si SCOPUS dhe Web of Science.
- Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, me mbështetje financiare.
- Sigurimi i qasjes në databazat shkencore si EBSCO dhe ScienceDirect për studentët dhe stafin.
- Implementimi i softuerëve antiplagjiaturë për sigurimin e cilësisë së punimeve shkencore.

### **Bashkëpunimi me Komunitetin dhe Industrinë**

UKZ ka krijuar **Bordin Këshillëdhënës Industrial**, i cili ka për qëllim:

- Ndërlidhjen e programeve akademike me nevojat e industrisë.
- Sigurimin e praktikave dhe projekteve për studentët.
- Përmirësimin e imazhit të universitetit në bashkëpunim me komunitetin.

### **Rezultatet dhe Objektivat e Synuara**

- Themelimi i bordit këshillëdhënës të programit për përfshirjen e palëve të interesit.
- Organizimi i konferencave shkencore dhe aktiviteteve profesionale në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
- Sigurimi i mbështetjes financiare për publikime shkencore dhe projekte kërkimore, përfshirë 30,000 euro të ndara nga Këshilli Drejtues.

### **Përkushtimi ndaj Cilësisë**

UKZ mbështet hulumtimet shkencore të cilësisë së lartë duke promovuar:

- Publikime në revista me impakt faktor.
- Njohjen e stafit përmes çmimit “Hulumtues i Vitit.”
- Përfshirjen e studentëve dhe stafit në projekte që sjellin përfitime për komunitetin dhe shoqërinë në tërësi.



Këto masa dhe angazhime dëshmojnë përkushtimin e UKZ ndaj zhvillimit shkencor dhe kontributit në përparimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës.

## 10. Studentët

**1. Pranimi dhe Regjistrimi i Studentëve** Universiteti i Kosovës në Gjilan (UKZ) mirëpret studentë nga mbarë vendi, duke ofruar një proces të strukturuar pranimi dhe regjistrimi. Kandidatët paraqesin dokumentacionin për regjistrim dhe marrin informacione të qarta mbi procesin. ID kartelat për studentët krijohen në formë elektronike dhe fizike për përdorim gjatë aktivitetit akademik. Sistemi SMU mundëson menaxhimin e të dhënave të studentëve, duke përfshirë regjistrimet, notat, provimet dhe pagesat administrative.

**2. Shërbimet për Studentët** Administrata e UKZ ofron shërbime të shumta për studentët, përfshirë:

- Kujdes për dokumentacionin e studentëve.
- Informacione mbi oraret e ligjërimeve dhe provimeve.
- Menaxhimin e bibliotekës universitare dhe e-bibliotekës digjitale.
- Mirëmbajtjen e internetit dhe shërbesave të tjera teknologjike.

Biblioteka e vendosur në katin e tretë të UKZ shërben si pikë kryesore për studime dhe huazime librash. Marrëveshjet me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe Asociacionin e Bibliotekave Elektronike sigurojnë akses në mbi 800,000 tituj librash dhe burime të tjera digjitale.

**3. Mbështetja Financiare dhe Bursat** UKZ mbështet studentët me forma të ndryshme të përkrahjes financiare, duke përfshirë:

- Fondin vjetor prej 65,000 eurosh për bursa studentore.
- Bursa nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASH).
- Mbështetje financiare nga komuna dhe operatorë ekonomikë.
- Bursa nga Rotary Club i Komunës së Gjilanit.

**4. Jetë Akademike dhe Praktike** UKZ synon përgatitjen e studentëve për karriera të suksesshme duke përbushur këto parime:

- Fokus evropian dhe ndërkombëtar në arsimin e lartë.
- Përkrahje për punën kërkimore dhe akademike.
- Angazhimi aktiv i studentëve në jetën universitare.

Programet e mësimin praktik janë të organizuara në bashkëpunim me institucione dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare si Erasmus+, Fulbright, HERAS dhe të tjera. Studentët gjithashtu mund të përfitohen nga shkëmbimet akademike dhe projekte të tjera ndërkombëtare.

**5. Etika dhe Disiplina Akademike** UKZ i kushton rëndësi të veçantë etikës akademike dhe disiplinës. Kodi i Etikës dhe rregulloret për masat disiplinore rregullojnë rastet e shkeljeve. Ndëshkimet variojnë nga vërejtjet me shkrim deri te përjashtimi i përhershëm nga universiteti. Plagjiatura trajtohet seriozisht, dhe stafi akademik ka qasje në softuerë të dedikuar për zbulimin e saj.

**6. Ankesat dhe Apelimet** Studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim kundër notave, cilësisë së mësimdhënies ose kushteve infrastrukturore. Procedurat janë të qarta dhe sigurojnë paañesi në trajtimin e rasteve nga komisionet shqyrtuese. Vendimet mund të apelojnë deri në MASHT ose në procedura gjyqësore.

**7. Shërbimet Shtesë** Për të ndihmuar studentët në zhvillimin personal dhe profesional, UKZ ofron:

- Këshillim akademik dhe planifikim të karrierës.
- Këshillim personal dhe psikologjik për menaxhimin e stresit dhe sfidave të tjera.
- Përgatitje për tregun e punës, përfshirë hartimin e CV-së dhe përgatitjen për intervista.

**8. Ambientet dhe Lehtësitë e Kampusit** Studentët kanë qasje në ambientet e konviktit dhe mensës së studentëve, si dhe mund të marrin pjesë në aktivitete sportive dhe rekreative. Marrëveshjet me Drejtorinë e Arsimit të Gjilanit mundësojnë shfrytëzimin e sallave sportive dhe ambulancën për kujdesin shëndetësor.

**9. Manuali i Studentit** Studentët e sapa regjistruar kanë në dispozicion një doracak, i cili përmban të gjitha informacionet e nevojshme mbi jetën studentore, rregulloret, programet studimore, oraret dhe shërbimet. Ky doracak është i disponueshëm si broshurë fizike dhe në uebfaqen e universitetit.

UKZ vazhdon të përkushtohet për krijimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet zhvillimin akademik dhe personal të studentëve, duke i përgatitur ata për karriera të suksesshme brenda dhe jashtë vendit.

## 11. Personeli Akademik dhe administrativ

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave të Kompjuterëve është i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore, si Prof. Asoc. Dr., dhe Prof. Ass. Dr., në përputhje të plotë me strukturën ligjore në lidhje me pozitat mësimdhënëse sipas Nenit Administrativ Nr.15/2018 Për Akreditimin e Institucioneve Arsimore të Larta të Republikës së Kosovës, datë 28.09.2018.

Në përputhje me Ligjin për Punë dhe Statutin e Universitetit, anëtar i stafit të plotë kohor konsiderohet çdo anëtar që nuk ka arritur moshën e pensionimit të 65 vjeçarëve. Në përputhje me AI mbi Akreditimin, për çdo 60 ECTS të programit të studimit duhet të ketë një doktor shkencor në pozicionin e bartesit të programit, në përputhje me nivelin Bachelor duhet të ketë 3 doktorë shkencë në cilesinë e stafit me kohe të plote dhe në nivelin Master duhet të ketë 2 doktorë shkencë në cilesinë e stafit me kohe të plote.

Ngarkesa mësimore për një staf akademik në fakultetin tonë është 6 orë mësimi të rregullt për profesorët (me mundësi 6 orë shtese) në javë dhe maksimumi 10 orë mësimi të rregullt për asistentët (me mundësi 10 orë shtese) në javë.

Secili profesor është i detyruar të mbajë dy orë konsultime me studentët në javë.

Programet e trajnimit për aftësi mësimore ofrohen rregullisht për të gjithë stafin mësimor, duke përfshirë ata përgjegjës për mësimdhënie dhe përdorimin efektiv të teknologjisë së re mësimore.

## 12. Cilësia

Sistemi i sigurimit të Cilësisë në UKZ përbën një gamë të gjerë të gjithëpërfshirjes së politikave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional duke përfshirë të gjitha proceset zhvillimore të institucionit mbi bazën e planifikimit dhe koordinimit me mekanizmat e brendshme dhe të jashtme të cilat orientojnë zhvillimin e vazhdueshëm të politikave për sigurim të cilësisë. Sistemi i sigurimit të cilësisë në universitet mbështetet në tri shtylla kryesore: Dokumente, organe dhe instrumente për vlerësim të cilat kontribuojnë në arritjen e objektivave drejt përmbushjes së misionit të UKZ-së.

Në kuadër të vlerësimit të cilësisë në universitet, UKZ ka ngritur kapacitetet duke emëruar Prorektorin për Zhvillim Akademik dhe Cilësi. Gjithashtu në vitin 2022 në kuadër të ZZHAC ka rekrutuar një zyrtare për Akreditim si dhe një zyrtare për Zhvillim në Karriere dhe Alumni. Në tetor të 2021 ZZHAC në bashkëpunim me KMCV – në ka hartuar Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë përmes të cilit janë planifikuar të gjitha aktivitetet për SC, të mbështetura në kornizën normative.

Në vitin 2023 UKZ ka miratuar politikat e reja për sigurim të cilësisë duke bërë rishikimin e të gjitha dokumenteve të aprovuara më 2020. Përmes këtyre masave është arritur që të bëhet plotësimi i dokumenteve duke u bazuar në rekomandimet e KMCV për përmirësime aty ku është hasur në vështësi të zbatimit. Përmes rishikimit të politikave për sigurim të cilësisë është arritur që dokumentet të bëhen më praktike dhe më të qasshme për realizim. Janë definuar të gjitha proceset, mekanizmat, instrumentet, raportimet grumbullimet e të dhënave, afatet kohore si dhe të gjitha përgjegjësitë e individëve dhe njërive të përfshira në proces.

Zbatimi i tërë sistemit të sigurimit të cilësisë në UKZ realizohet duke u mbështetur në këto dokumente: Statutin e UKZ së, Planin Startegjik, Rregulloren për Sigurim të Cilësisë, Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës, Treguesit Kryesor të Performancës dhe Udhëzuesit e ECTS (të rishikuara 2023). Përmes Rregullores për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit definohet sistemi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, mekanizmat, instrumentet, akterët e sigurimit të cilësisë, gjithashtu rregullorja përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces.

Gjithashtu që nga viti 2020 UKZ ka nxjerrë edhe [rregulloren për funksionimin e Këshillit Mbikqyrës për Cilësi dhe Vlerësim](#) Nr. 01/2913 dt. 18.12.2023 e cila përcakton mënyrën e funksionimit të këtij organi. KMCV është një organ këshillues, i cili në bashkëpunim me organet e tjera profesionale të UKZ, planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga UKZ.

Vlerësimi i performancës së SA në UKZ zhvillohet përmes Manualit për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës (MPVP) i cili në aspektin institucional është i rëndësishëm për të planifikuar, monitoruar, vlerësuar, zhvilluar dhe afirmuar përsosmërinë e performancës në përmbushjen e misionit dhe objektivave të UKZ, përmirësimin e shërbimeve ndaj shoqërisë dhe studentëve përmes mesimdhënies cilësore, përmirësimin e kurrikulave dhe programeve studimore; mundëson harmonizimin e objektivave të performancës së stafit akademik me standardet e performancës të përcaktuara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, si dhe identifikimin e nivelit të kompetencave të stafit akademik në fushën e kërkimit dhe kushtet për punën e tyre kërkimore që ofron UKZ.

UKZ nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit bën matjen e cilësisë në disa dimensione duke përdorin një numër të konsiderueshëm të pyetësorëve:

1. Pyetësori për studentë lidhur me shërbimet administrative në UKZ
2. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e Profesorëve të UKZ
3. Pyetësori për studentë lidhur me vlerësimin e asistentëve të UKZ
4. Pyetësori për vetëvlerësim të stafit akademik
5. Pyetësori për vlerësim Dekani- Mesimdhënësin
6. Pyetësori për vlerësim Sekretari –Zyrtarët Administrativ
7. Pyetësori për alumni
8. Pyetësori për studentët para diplomimit
9. Pyetësori për studentët që braktisin studimet në UKZ
10. Pyetësori për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi

UKZ duke u mbështetur në cilësinë e rezultateve nga raportet e vlerësimit në vazhdimësi bën rishikim metodologjisë së vlerësimit duke bërë modifikim të instrumenteve për vlerësim më qëllim që sa më shumë të rritet cilësia e vlerësimit.

Pasi sigurimi i cilësisë në UKZ është i pavarur dhe realizohet përmes një procesi të centralizuar, duke garantuar objektivitet të lartë, të gjitha këto rregulla, organe, procedura dhe instrumente vlejné edhe për programin e studimit marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane.

Proceset e sigurimit të cilësisë në UKZ menaxhohen nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi e cila është funksionale që nga viti 2018. Zyra përbëhet nga Drejtori, zyrtari për Akreditim si dhe zyrtari për Zhvillim në Karrierë dhe Alumni.

ZZhAC koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e vlerësimit të performancës së stafit akademik si dhe me procesin e akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që përfshijnë këto procese dhe poashtu koordinon punën e zyrës me zyrën e Prorektorin për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, me Senatin, Këshillat e Fakulteteve, komisioneve dhe grupeve të tjera punuese.

Këshilli Menaxhues për Cilësi dhe Vlerësim (KMCV) përbëhet nga Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi i cili është edhe kryesues, nga prodekanët e pesë NJA, një zyrtarë nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, Zyra për Çështje Akademike si dhe dy studentë përfaqësues, gjithsej dhjetë anëtarë.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, programi do të caktoj koordinatorin për Cilësi, i cili/cila ka detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme në rrafshin e të siguruarit të cilësisë brenda programi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane. Koordinatorin e Cilësisë, anëtar i stafit akademik, është urë lidhëse në mes njësisë akademike dhe ZZhAC. Ai i raporton menaxhmentit dhe KF.

Koordinatorin e Cilësisë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Udhëzon stafin akademik dhe studentët në kuadër të njësisë akademike lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së;

- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentëve, bizneseve, anëtarëve të Bordit këshillëdhënës, etj.), për hartimin/rishikimin e programeve të studimit gjatë procesit të ri/akreditimit;
- Është pjesë e planifikimit dhe monitorimit të procesit të vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, si dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike ndihmon në sistemimin e të dhënave dhe informatave lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimin e punimeve shkencore, performancës artistike, projekteve profesionale dhe shkencore);
- Këshillon, planifikon, dhe monitoron skema, aktivitete dhe veprimtari për ngritjen e cilësisë në njësinë akademike. Po ashtu, Koordinatorin kujdeset për cilësinë e dokumenteve dhe informacioneve nga fusha akademike e fakultetit të publikuara në Ueb-faqe.

Rezultatet e vlerësimeve të brendshme dhe raportet e hartuara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë shërbejnë si udhërrëfyes për ndryshime drejt përmirësimit të cilësisë së programit.

Në Objektivin strategjik 5. Zhvillimi i praktikave efektive menaxheriale në Planin Strategjik 2023/2028 përveç objektivave është përcaktuar edhe rishikimi i rregullave, organeve dhe proceseve, kompetencave sipas praktikave bashkohore në mënyrë që të avancojmë procesin e ngritjes së cilësisë nëpër programe studimore.

Sigurimi i cilësisë në UKZ, mbështetet edhe nga projekte të ndryshme ndërkombëtare në të cilat është partner UKZ siç janë: QATEK (Erasmus+), Research Cult, HERAS.

Sistemi i sigurimit të cilësisë mbulon aktivitete në programin studimor, për sigurim të cilësisë ku përfshihet planifikimi, zbatimi, vlerësimi dhe rishikimi. E gjithë kjo mbështetet në dokumentacionet në fuqi, në mënyrë të detajuar këto aktivitete janë paraparë në Kalendarin Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.

Në UKZ, në kuadër të Kalendarit vjetor për sigurim të Cilësisë janë planifikuar të gjitha aktivitetet për sigurim të Cilësisë që përfshijnë edhe vlerësimet e rregullta të shpërndara nëpër javë përgjatë tërë vitit akademik nga shtatori deri në korrik.

Në fund të vitit hartohet raporti i mbikëqyrjes mbi të cilin ZZHAC dhe KMCV rekomandon përditësimin e Kalendarit Vjetor për sigurim të Cilësisë.

Nga viti 2020, Stafi Akademik përmes Planit Zhvillimor Individual, çdo fillim viti bën planifikimin e punës së tyre në disa dimensione i cili përfshin 4 objektiva e të cilat janë: Procesi Mësimor, Punë kërkimore-shkencore/Vepra artistike, Shërbimet menaxheriale, Shërbimet për shoqëri.

Në fillim të çdo viti akademik, nga Koordinatorin i Cilësisë së NJA bëhet mbikëqyrja e realizimit të PZHI, vlerësimi përfundimtar i dorëzohet Dekanit, kështu PZHI bën pjesë në vlerësimin e performancës së SA dhe për çdo vit bëhet planifikimi i ri nga SA.

Gjate shqyrtimit të raporteve analizohet cilësia e rezultateve dhe bëhen ndërhyrjet e nevojshme për rishikim të pyetësorve që të shërbejnë për të ardhmen për vlerësime sa më objektive.

[Për të gjitha vlerësimet hartohen raporte të veçanta si në vijim:](#)

1. Raport Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin dimëror
2. Raport Vlerësimi i SA si dhe lëndëve nga ana e studenteve për semestrin veror
3. Raport Vetëvlerësimi nga Mësimdhënësit
4. Raport Vlerësimi i Shërbimeve Administrative nga ana e studentit
5. Raport Vlerësimi i Programeve të UKZ-së nga Alumni
6. Raport Vlerësimi i UKZ-së nga Punëdhënësit
7. Raport Vlerësimi për student para diplomimit
8. Raport Vlerësimi për studentët që braktisin studimet në UKZ
9. Raport Vlerësimi për vlerësim të jashtëm/ punëdhënësi



## 10. Raport Vlerësimi i Kalendarit Vjetor për sigurim të cilësisë

Kështu vlerësimet janë pjesë e rishikimit të performancës së aktiviteteve të përditshme si dhe objektivave strategjike të përcaktuara me rregullativën për sigurim të cilësisë që u ofron një mundësi për të reflektuar. Nga rezultatet e marra, mekanizmat që punojnë në sigurim të cilësisë marrin parasysh inputet, sygjerimet, pastaj kjo reflektohet në përmirësime të vazhdueshme të planifikimit.

ZZhAC, ka krijuar një bazë me të dhëna të grumbulluara nga vlerësimet përgjatë viteve. Këto të dhëna janë të disponueshme për të gjitha palët e interesit. ZZHAC-ja, posedon të dhënat si në vijim:

- **Materialet e dorës së parë** (Pyetësorë: Kopje fizike dhe elektronike)
- **Rezultatet e hulumtimeve** (Rezultatet e përgjithshme për institucionin, njësitë akademike dhe personelin akademik dhe administrativ)

UKZ-ja posedon këto lloje të raporteve:

1. Raportet nga hulumtimet në formë fizike
2. Raporte në formë elektronike
3. Raportet nga SMU
4. Raportet nga Moodle
5. Raportet nga UKZ platforma
6. Raportet nga Google Form
7. Raportet nga aparati i vijueshmërisë

Në përfundim të secilit semestër dhe gjithashtu në mbyllje të çdo viti akademik, brenda çdo Fakulteti, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të UKZ-së një Raport Përmbledhës për Vlerësimin e Stafit Akademik dhe lëndëve. Ky raport do të përfshijë një analizë të hollësishme të arriturave dhe sfidave për semestrin ose vitin akademik të përfunduar. Kjo praktikë jo vetëm që motivon stafin akademik, por gjithashtu ndihmon në identifikimin e sfidave potenciale, me qëllim që ato të adresohen dhe eliminohen në të ardhmen.

Instrumentet për Vlerësim të performancës së stafit akademik dhe administrativ realizohen duke u bazuar ne [Manualin për Planifikim dhe Vlerësim të Performancës së SA](#) Nr. 01/2912 dt. 18.12.2023. Gjatë analizës së rezultateve KMCV, janë diskutuar përgjigjet dhe rrjedhimisht janë propozuar ndryshimet në pyetësor me qëllim të arritjes së rezultateve të synuara. Për Vlerësimin e SA nga ana e studentëve, gjatë kësaj periudhe është përdorur një format përafërsisht i njëjtë me disa ndryshime të propozuara nga KMCV. Ndryshime më të theksuara janë bërë në pyetësorin për Vlerësimin e Administratës nga ana e studentëve, vlerësimin e palëve të interesit të cilët kanë vlerësuar studentët tanë të diplomuar. Pra, UKZ ka bërë standardizimin e pyetësorëve për fushat me interes për vlerësim.

Rezultatet e vlerësimit analizohen nga ZZhAC dhe nga Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësim. Te dhënat e të gjitha anketimeve grumbullohen, përpunohen me softuer adekuat dhe publikohen ne uebfaqe. Krahasimet bëhen për të shikuar trendin e zhvillimit, në mënyrë që të ndërmarë masat për përmisim të mëtejshëm.

Raportet e rezymuara bëhen publike edhe në ueb faqen e UKZ dhe raportohen edhe në Senatën e Universitetit, ndërsa raportet me detaje për secilin staf i raportohen Dekanit të Fakultetit dhe vetë stafit konkret.

Të gjitha këto vlerësime (anketa, pyetësorë etj.) ruhen në Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, ndërsa raportet e kësaj Zyre arkivohen dhe ruhen në Arkivin e UKZ, sipas Ligji Nr. 04/L-088 Për Arkivat Shtetërore.

Udhëheqësi i programit, pas përfundimit të çdo semestri, do të posedojë Raportet e Vlerësimit, të cilat përmbajnë të dhëna për secilin staf akademik të rregullt dhe të angazhuar, si dhe për stafin administrativ. Këto të dhëna po ashtu shërbejnë dhe përdoren si një indikator ne procesin e avancimit dhe të angazhimit të stafit akademik dhe administrative.

Programi ka paraparë që të shtohet edhe një instrument i ri i vlerësimit, ku profesori do të vlerësojë studentët që kanë ndjekur lëndën e tij. Kjo do të mundësojë që të kemi një pasqyrë edhe më shtesë për nivelin e angazhimit të studentëve në lëndë të caktuara.

Gjithashtu, në kuadër të Universitetit për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë merren parasysh:

- Mbikëqyrja e rregullt e aparatit për evidentim të hyrje-daljeve të stafit akademik dhe administrativ;
- Këshillat e Fakulteteve në vazhdimësi evidentojnë dhe përmirësojnë programet e studimeve, bazuar në nevoja, duke gjetë mbështetje në rregulloren për studimet bachelor, master dhe duke u bazuar në udhëzuesin administrativ të AKA-së (15/18);
- Programet studimore kanë të inkorporuar praktikat profesionale si pjesë e programeve të studimit;
- Këshillat e Fakulteteve miratojnë ndryshimet e syllabusëve të lëndëve si dhe hartimin e tyre sipas taksonomise së Blumit;
- Është bërë riorganizimi i administratës, që ka bërë që të përmirësohen shërbimet administrative për studentë;
- Përmes SMU vlerësohen studimet në UKZ nga studentët paradiplomimit (pasi përfundojnë të gjitha provimet);
- Përmes SMU vlerësohen arsyet e braktisjes së studimeve;
- Çdo vit akademik mbikëqyret suksesi (kalueshmëria) e studentëve.

Çdo vlerësim i bërë i dërgohet në mënyrë individuale dhe elektronike stafit akademik dhe ky vlerësim ju shërben atyre dhe stafit drejtues të UKZ për të reflektuar dhe për të vlerësuar se në çfarë gjendje është UKZ sa i përket cilësisë së procesit të mësimi. Pas përpunimit të të dhënave, ZZHAC në bashkëpunim me KMCV, analizon të dhënat, nxjerr rekomandimet dhe harton raportin e gjetjeve. Në kuadër të kësaj, akterët përgjegjës për siguri dhe vlerësim të cilësisë ndërmarrin hapa për rishikimin e instrumenteve vlerësuese, duke u bazuar në rezultatet dhe inputet e raporteve.

Rregullimet e sigurimit të Cilësisë Vetëvlerësohen, raportohen dhe përmirësohen rregullisht për të siguruar standardet dhe efikasitetin e tyre në kohë. Sistemi i sigurimit të cilësisë në vazhdimësi ka mbikëqyrje nga KMCV, ZZhAC-ja, Njësitë Akadematike, Senati dhe KD i UKZ-së. Të gjitha këto organe në baza të rregullta mbikëqyrin zhvillimin e planit strategjik të UKZ-së përmes Planit të Veprimit duke evidentuar sfidat të cilat hasen gjatë realizimit të aktiviteteve të parapara. Poashtu, Plani Strategjik i UKZ-së është miratuar nga Këshilli Drejtues për

periudhën 2023-2028 i cili përmban pesë objektiva strategjike të cilat në fokus e kanë ngritjen e cilësisë.

## 13. Infrastruktura dhe pajisjet

Universiteti ka një sipërfaqe e cila i plotëson nevojat e programit Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet evropiane. Kampusi ekzistues përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të ndërlidhura midis tyre dhe të përshtatshme për aktivitete mësimore. Gjetet në një pozitë të përshtatshme, brenda qytetit, me një mundësi të përshtatshme për qasje nga studentët dhe stafi. Objekti kryesor ka një hapësirë prej 6500 m<sup>2</sup> për zyrat e stafit akademik dhe administrativ, sallat e mësimi, laboratorët, kabinetet, bibliotekën dhe infrastrukturën tjetër të paraqitur në tabelën 1 dhe 2, ndërsa komplet Kampusi i UKZ-së në total ka një hapësirë prej 2ha ose 20000 m<sup>2</sup>. UKZ, bashkë me Komunën e Gjilanit dhe me Qeverinë e Kosovës është duke planifikuar zgjerimin e kampusit aktual edhe me një objekt të madh apo ndërtimin edhe të një kampusi të ri, ose zgjerimin e kampusit ekzistues.

UKZ ka një objekt, i cili përbëhet nga salla mjaft cilësore, me mjete teknologjike më të reja, si Smart Board, Projektor dhe pajisje tjera teknologjike, pastaj shpërndarja e Laptopëve për profesorë, etj.

Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka siguruar e MS365 (programet nga paketa e Microsoft Office). Licencat janë në kohëzgjatje tre vjeçare (Nëntor 2023 – Nëntor 2026) dhe mundësohen nga Qeveria e Kosovës/Ministria e Ekonomisë përmes projektit KODE, për të gjithë stafin akademik, administrativ dhe studentët. Stafi i universitetit ka qasje edhe në softuer të ndryshëm, gjithashtu ofrohen softuer të tjerë të cilët janë Open Source. Sistemi i Menaxhimit Universitar – SMU është platforma përmes të cilës automatizohen dhe optimizohen të gjitha proceset e lidhura me studimet. UKZ përdor platformën E-learning (Moodle). Universiteti ynë përdor platformën Guide for Education për të përmirësuar përvojën e mësimi dhe bashkëpunimit në mes studentëve, personelit akademik dhe personelit administrativ. [Universiteti përdor edhe databzat e përmendura në pjesën e Hulumtimit për qasje në burime shkencore.](#)

Inventari i UKZ menaxhohet, monitorohet dhe shpërndahe sipas kërkesave të aprovuara. Zyrtarja e Pasurisë dhe Zyrtarja e Depos kujdesen për inventarin. Për menaxhimin e inventarit përdoret sistemi e-Pasuria.

UKZ është universitet publik dhe financohet nga Buxheti i Kosovës. MASHT cakton tarifat e shkollimit. UKZ harton Buxhetin e vet në konsultim me MASHT dhe Ministrinë e Financave, dhe i njëjti miratohet në kuadër të Ligjit të Buxhetit të Kosovës. Plani i financimit të programit aktual është pjesë e planit të financimit të UKZ si dhe planit të prokurimit të bashkëlidhur si shtojcë. (shih: Plani financiar 2024, Plani i Prokurimit 2024 UKZ).

Programi aktivitetin do ta zhvilloj në kampusin qendror të Universitetit. Hapësirat për zhvillimin e veprimtarisë së programit janë të mjaftueshme dhe plotësojnë kriteret e nevojshëm për veprimtarinë e programit. Kampusi i UKZ është në rrugën “Zija Shemsiu”, në qendër të Gjilanit. Ai përbëhet prej dy objekteve të mëdha, të bashkuara në rikonstruktim. Kampusi është në kufi me Kampusin e Shkollave të Mesme të qytetit, duke e shndërruar gjithë zonën në zonë shkollore, dhe universitare. Kampusi nuk i plotëson të gjitha nevojat në zhvillimin dinamik të UKZ, prandaj UKZ në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit dhe Qeverinë e Kosovës kanë gjetur një zgjidhje për një kampus të ri të universitetit, e bërë kjo përmes [zotimit të Kryetarit të Komunës së Gjilanit](#). E cila do të finalizohet përmes vendimit të KK. Gjilan. UKZ po ashtu edhe brenda kampusit të tashëm në vitin 2020-2023 ka shtuar hapësira të reja mësimore dhe bibliotekare.

Sa i përket numrit të ulëseve në sallat ku mbahen ligjëratat, seminarët etj, janë të mjaftueshme për grupet e studenteve të programit, duke përfshirë kurrikulat sipas plan programit mësimorë. Universiteti është i pajisur me pajisje solide për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve.

Struktura e hapësirave për ligjëratat është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B. Kjo shpërndarje është si në vijim:

| <b>Hyrja A</b> |               | <b>Hyrja B</b> |               |
|----------------|---------------|----------------|---------------|
| Salla nr.      | Nr. i ulëseve | Salla nr.      | Nr. i ulëseve |
| A/01           | 110           | B01            | 100           |
| A/02           | 120           | B02            | 100           |
| A12            | 70            | B03            | 30            |
| A13            | LAB.BSHN      | B04            | 30            |

|              |                |     |                             |
|--------------|----------------|-----|-----------------------------|
| A14          | 70             | B10 | Kabinet IT/30               |
| A21          | 35             | B11 | 150                         |
| A22          | 70             | B12 | Kabinet IT/30               |
| A23          | 40             | B13 | 40                          |
| A24          | Kabinet Muz 30 | B21 | 100                         |
| A25          | 30             | B22 | 50                          |
| A26          | Kabinet Art 30 | B23 | Kabinet Routers Sëitches 50 |
| A27          | 30             | B24 | Kabinet IT/35               |
| A31          | 60             | B31 | Kabinet IT/35               |
| A33          | 30             |     |                             |
| <b>Total</b> | <b>695</b>     |     | <b>790</b>                  |

Tabela 1. Struktura e hapësirave për ligjërata është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B.

Stafi i universitetit janë të pajisur me laptop, pajisje lëvizëse për ruajtjen e të dhënave si USB, ndërsa zyrat e tyre janë të pajisura me kompjuter desktop dhe printerë për të përmirësuar efikasitetin e punës. Për të siguruar një ambient të përshtatshëm mësimor, programi është e pajisur me fotokopjues dhe material shpenzues të nevojshëm, duke përfshirë letër dhe toner për fotokopjues. Sallat e mësimi janë të pajisura me projektorë për të mundësuar prezantimet multimediale dhe një përvojë mësimore më dinamike. Përveç sallave të mësimi në universitet janë disa laboratorë të informatikës, të cilat janë të pajisura me kompjuterë dhe pajisje të tjera teknologjike në nivel të lartë, që mund të shërbejnë si hapësira për zhvillimin e hulumtimeve të gjera sociale.

Në hapësirat e UKZ-së në Gjilan, ekziston një strukturë e mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Struktura e hapësirave duke përfshirë zyret e administratës, sallave të mësimi, laboratorëve, kabineteve, bibliotekës etj., paraqitet me anë të tabelës në vijim. Universiteti ka dy salla të vogla, të cilat janë të pajisura me mjete të nevojshme teknologjike dhe shërbejnë ekskluzivisht vetëm për hulumtime grupore.

|                                     | Përdoren nga stafi akademik | Përdoren nga stafi administrativ | Përdoren nga studentët | Total kompjuterë |
|-------------------------------------|-----------------------------|----------------------------------|------------------------|------------------|
| Numri i përgjithshëm i kompjuterëve | 97                          | 48                               | 125                    | 218              |

Tabela 2: Numri total i kompjuterëve (desktop dhe laptop) funksionalë që disponon universiteti.

| Lloji i pajisjes | Numri total i pajisjeve |
|------------------|-------------------------|
| Projektor        | 45                      |
| Smart Board      | 13                      |
| Smart TV         | 6                       |

|  |     |
|--|-----|
| Makinë fotokopjuese                      | 19  |
| Printer                                  | 85  |
| Kompjuterë në laboratorë të Informatikës | 110 |
| Kompjuterë për stafin akademik           | 70  |
| Kompjuterë për administratë              | 38  |
| Laptop                                   | 52  |
| Printer për ID-kartela                   | 1   |
| Lexues Optik                             | 1   |
| ËiFi (Modem)                             | 55  |
| Server                                   | 2   |
| Pajisje Laboratorike                     | 15  |
| Grafoskop                                | 13  |
| Kamera të sigurisë                       | 58  |
| Aparat Profesional Fotografik            | 4   |
| Router                                   | 6   |
| Sëitch të menaxhueshëm                   | 25  |
| Sëitch të thjeshtë                       | 15  |
| UPS                                      | 50  |
| Scanner                                  | 4   |

Tabela 3: Numri total i pajisjeve të tjera teknologjike funksionale që disponon universiteti.

Përveç pajisjeve të listuara më lartë, Universiteti ka përfituar grante nga projektet e ndryshme si: Euforia, ReBus, E viva, Quadic etj, përmes të cilave grante ka pasuruar fondin e pajisjeve të ndryshme që i lehtëson aktivitetet akademike.

| Lloji i pajisjes  | Numri total i pajisjeve |
|---|-------------------------|
| Laptop  | 108                     |
| Desktop Lenovo ALL IN ONE                                 | 60                      |
| Video Projektor   | 15                      |
| Mobile Projektor  | 4                       |
| Aparat Proffesional                                       | 1                       |
| Printer Multifunksional                                   | 5                       |
| Printer 3D  | 2                       |
| Kamera Ultra HD   | 2                       |
| Kompjuter Desktop   | 18                      |
| Video Conference Sound System – Online learning equipment | 4                       |

Tabela 4: Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme

Universiteti ka në dispozicion bibliotekën e cila në fondin e saj ka literaturë në gjuhën shqipe, angleze, serbokroate dhe një fond më të kufizuar në gjuhën greke, spanjolle dhe turke.

Fondi i përgjithshëm i librave është 54,000 ekzemplarë. Përveç bibliotekës së universitetit, studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturën e cila gjendet në Bibliotekën e Qytetit “Fan S. Noli” në Gjilan. Me qëllim të begatimit të titujve të librave në bibliotekën e UKZ-së është lidhur marrëveshje me Rrjetin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës. UKZ është pjesë e projektit

Erasmus+ “ResearchCult” me anë të cilit do të krijohet qasja në një bibliotekë ndërkombëtare; UKZ furnizohet me libra edhe nëpërmjet projekteve Erasmus+, si me SMAHPS, ENEMLOS etj. Përdoruesit mund t’i qasen bazave të të dhënave dhe burimeve të cilat janë pa pagesë si dhe atyre në kuadër të databazat e [Universitetit në rrjete ndërkombëtare](#).

Procesi i digjitalizimit të Bibliotekës është në vazhdim. Stafi është i trajnuar për softuerin COBISS. Zyrtarja e bibliotekës është e licencuar për përdorimin e këtij softueri dhe është duke regjistruar librat në sistem. Biblioteka punon nga ora 8 deri në 16. Salla e leximit në bibliotekë është e qasshme dhe e shfrytëzueshme prej të hënës deri të shtunën nga ora 8 deri 20.

UKZ blenë libra dhe mjete të tjera edukative njëherë në vit, apo edhe sipas nevojës. Biblioteka pasurohet nga burime të ndryshme, si burime të brendshme nga universiteti dhe nga burime të jashtme si: GIZ-i, ASHAK, MASHT-i, Erasmus +, QATEK, SMAHPC, ASHSH, Instituti i Historisë në Prishtinë, dhurata nga profesorët e universitetit si dhe nga autorë të jashtëm. Gjithashtu, Universiteti ka nxjerrë rregullore sipas së cilës, çdo autor obligohet t’i dorëzoj 10 ekzemplarë në bibliotekën e Universitetit (Rregullore për punën e Këshillit Botues).

UKZ ofron kushte për personat me nevoja të veçanta (psh. hyrja, ashensori, banjo, përcjellja etj). Nga data 24.02.2023 UKZ ka bërë furnizimin dhe montimin me lift me Standardet konform Rregullores se Ministrisë se Tregtisë se Kosovës (MTI) me Nr. 03/2017, per sigurinë e ashensorëve ne përdorim. Lifti ka përmbushë standardin Kosovar SK EN 81 – 20:2014 dhe SK EN 81-50:2014, Rregullat e Sigurisë per konstruktimin dhe instalimin e ashensorëve, i cili shërben për gjithë stafin e UKZ-së dhe për të gjithë studentët të cilen kanë nevojë për shfrytëzimin e tij ( për katet 1,2, dhe 3) , me certifikatën e konformitetit me numër 039/2023 te dhëne nga trupi inspektues “EALGA “ SH.P.K nga Prishtina.



## 14. Plani i detajuar i veprimit

| Aktiviteti   | Afati kohor | Bartësit/Pergjegjesit                     | Mbikqyresit   | Kosto | Komente  |
|--|-------------|---|---|-------|--|
| 1. Hartimi i një programi të ri në fushën e shkencave kompjuterike -<br><b>Programi: Artificial intelligence, Akademik</b> | 2024-2025   | Fakulteti i Shkencave Kompjuterike        | Menaxhmenti i FSHK-se   |       |  |
| 2. Hartimi i një programi të ri në fushën e shkencave kompjuterike -<br><b>Cyber Security - Aplikativ, niveli 5</b>        | 2024-2025   | Fakulteti i Shkencave Kompjuterike        | Menaxhmenti i FSHK-se   |       |  |
| 3. Formimi i Grupit Punues për të analizuar programet ekzistuese të FSHK-se dhe identifikuar mundësitë e reformimit        | 2024-2025   | Dekani i FSHK-se<br>Bartësit e Programeve | Prorektori për Mësim<br>Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi |       |  |
| 4. Rishikim i sillabuseve, integrimi në programet që kalojnë në  | 2024-2025   | Stafi Akademik                            | Dekani i FSHK-se<br>Prodekani i FSHK-se<br>ZZHAC                    |       | Per programet master SKIA dhe e- Qeverisje jane rishikuar syllabuset |

|   |           |                              |                       |      |   |
|---|-----------|------------------------------|-----------------------|------|---|
| riakreditim.<br><b>Implementimi i Taksonomise se Bloomit (TB) ne te gjitha lendet qe ofrohen ne Fakultetin e Shkencave Kompjuterike ne nivel Bachelor dhe Master, me mundesi perdorimi te te gjitha niveleve te TB-se pasi qe TB ka studentin ne qender. Implementimi I TB-se te kryhet duke perdorur sistemet si T-Edu dhe e-Learning.</b> |           |                              |                       |      | ne prcesin e riakreditimit. Syllabuest e programit Shkenca Kompjuterike ne nivelin bachelor duhet te rishikohen per riakreditimin e radhes. |
| 5. Këshilli i Fakultetit harton veprimet për përmirësim   | 2025      | Këshilli i Fakultetit        | Menaxhmenti i FSHK-se |      |   |
| 6.Rekrutimi Stafit Akademik sipas nevojave të FSHK-se per programe aktuale dhe te reja.   | 2024-2025 | Këshilli I Fakultetit Senati | Menaxhmenti i UKZ-se  |      |   |
| 7. Mbeshtetja e stafit per kryerjen e trajnimeve praktike qe u nevoiten per   | 2024-2025 | Këshilli I Fakultetit Senati | Menaxhmenti i UKZ-se  | 4000 |   |

|   |             |   |  |      |   |
|---|-------------|---|--|------|---|
| fitimin e njohurive te reja praktike sipas trandit global ne menyre qe planprogramet ne te ardhmen te jene edhe me te avancuara.  |             |   |  |      |   |
| 8.Organizohen 5 trajnime :<br>- Hartimi i Rezultateve të të nxënit<br>- Vlerësimi i Programeve Studimore<br>- Mësimdhënia Interaktive në AL ( <b>Bloom Taxonomy</b> )<br>- Metodologji e Hulumtimit Shkencor<br>- Gjuhë angleze - | 2024-2025   | Prorektorët<br>ZZHAC  | Menaxhmenti i UKZ                                | 8000 |   |
| 9.Organizohen anketime dhe konsulta tjera me palët e Jashtme të interesit çdo dy vjet, për nevojat e tregut dhe kenaqëshmërinë me studentët e diplomuar;  | 2024 - 2025 | Menaxhmenti i Fakultetetve<br>Zyrtarja për Zhvillim në Karrere dhe Alumni | Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ZHAC | 250  | Jane organizuar takime ne kuader te riakreditimit te programeve master. Per nivelin bachelor duhet te organizohet takim para fillimit te pergaditjes se dokumentimit per riakreditim te |

|  |           |  |  |  |  |
|--|-----------|--|--|--|--|
|  |           |  |  |  | programit Shkenca Kompjuterike.  |
| 10. Inkorporohen mësimet e nxjerra nga konsultat me tregun e punës në rishikimin e programeve dhe në kohën e riakreditimit | 2024-2025 | Menaxhmenti i Fakultetëve<br>Zyrtarja për Zhvillim në Karrere dhe Alumni | Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ZHAC |  | Jane inkorporuar mesimet e nxjerra nga takimet ne kuader te riakreditimit te programeve master. Per nivelin bachelor duhet te organizohet takim para fillimit te pergaditjes se dokumentimit per riakreditim te programit Shkenca Kompjuterike pastaj te inkorporohen mesimet e nxjerra. |
| 11. Fuqizohet dhe digjitalizohet sistemi i vlerësimit të performances së stafit akademik duke inkurajuar vetëvlerësimin;   | 2024-2025 | Menaxhmenti i FSHK-se<br>Zyrtarja për Zhvillim në Karrere dhe Alumni     | Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ZHAC |  | Ka disa vleresime dhe vetevleresime ne SMU te cilat duhet te rishikohen,   |
| 12. Formimi i Grupit Hulumtues në FSHK sipas fushave hulumtuese  | 2024      | Prorektorja për Hulumtime Shkencore<br>Menaxhmenti I FSHK-se             | Menaxhmenti I lartë                              |  | Eshte krijuar grupi hulumtues  |

|   |           |   |                     |           |  |
|---|-----------|---|---------------------|-----------|--|
| 13. Publikimi i rezultatetve të Projekteve hulumtuese   | 2025      | Prorektorja për Hulumtime Shkencore Menaxhmenti I FSHK-se             | Menaxhmenti I lartë |           | Duhet te kete rregullore per menyren e publikimit te rezultateve te projekteve hulumtuese ne menyre qe te meren parasysh aspektet ligjore dhe privatesia e te dhenave. |
| 14. Financohet një projekt kërkimor për FSHK nga fondi I UKZ-së                                   | 2024-2025 | Prorektorja për Hulumtime Shkencore Prorektori për Buxhet dhe Financa | Këshilli Shkencor   | 5000      | Stafi i FSHK-se duhet te beje kerkese per financim ne nivel Universitti  |
| 15. FSHK te aplikon me të paktën një projekt në vit për fondet vendore                            | 2024-2025 | Stafi akademik, Menaxhmenti i FSHK-se                                 | Menaxhmenti I lartë | 5000      |  |
| 16. Realizimi i aktiviteteve në programin Guest Speake (Këshilli vendos për emërtim të programit) | 2024-2025 |   |                     | 1000      |  |
| 17. Realizimi i trajnimit të stafit për hartimin e projekt propozimeve (ndërkombëtare).           | 2025      |   |                     | 2000 Euro |  |